



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:350829

Datë: 19.12.2024

Numri i dokumentit: 06628296

**PS.nr.100/24**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti Special**, me gjyqtaren, Violeta Namani-Hajra, Kryetare e trupit gjykues, me zyrtaren ligjore Ardita Mustafa, në çështjen penale kundër të pandehurit **Dusan Drobac** për shkak të veprave penale: *Sulmi ndaj personit zyrtar*, nga neni 402 par. 4 lidhur me par. 2 nenin 31 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, si dhe veprën penale: *Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi*, nga neni 404 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr. 44/23, datë 10.12.2024, si dhe marrëveshjes për pranimin e fajësisë PPS.nr.44/23, e datës 09.12.2024, në seancën dëgjimore lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, gjatë seancës të hapur, verbale të mbajtur me datë 18.12.2024, në praninë e Prokurorit Special Bekim Kodraliu, të pandehurit Dusan Drobac me mbrojtësen e tij av. Drita Hoxha, në bazë të nenit 364 të KPPK-së, gjykata të njëjtë ditë mori dhe publikisht shpalli, dhe me datë **18.12.2024**, përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### **Kundër të pandehurit:**

**Dusan Drobac**, nga i ati ... dhe e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur me datë të lindjes..., në ..., me vendbanim në rrugën "...", nr. ..., objekti "...", në ..., i martuar, baba i tre fëmijëve, me profesion ekonomist, i punësuar në Strukturat Ilegale Serbe në Mitrovicë Veri, me numër personal: ..., i nacionalitetit serb, me nënshtetësi të Republikës së Kosovës dhe të Serbisë, gjendet nën masën e paraburgimit nga data 24.07.2024.

### ËSHTË FAJTOR

## I.

Me datë 29.05.2023, në intervalin kohor duke filluar nga ora 06:00 e deri në orët e mbrëmjes, në perimetrin në të cilin gjendet objekti i Komunës së Zveçanit, i pandehuri **Dusan Drobac**, në koordinim me shumë të pandehur të tjerë, ka marrë pjesë aktiv në grupin e personave në kryerjen e veprave penale serioze, në atë mënyrë që përmes përdorimit të dhunës i kanë sulmuar dhe seriozisht i kanë kanosur ushtarët e misionit paqeruajtës të KFOR-it, **duke përdorë mjete të forta, shufra të ndryshme, molotov, mjete shpërthyesë të improvizuara si dhe armë të zjarrit, nga të cilat janë lënduar të paktën 30 (tridhjetë) pjesëtarë të forcave paqeruajtëse të KFOR-it, 3 (tre) nga ta nga predhat e armëve të zjarrit, si dhe disa pjesëtarë të Policisë së Kosovës**, të cilët kanë qenë në detyrë zyrtare për të garantuar rendin dhe qetësinë publike për të gjithë qytetarët në atë pjesë, nga të cilat veprime kanë rrezikuar seriozisht jetën dhe trupin e këtyre personave zyrtarë, e të cilëve edhe u kanë shkaktuar lëndime trupore.

- **Me këto veprime i pandehuri në bashkëkryerje e ka kryer veprën penale: *Sulmi ndaj personit zyrtar*, nga neni 402 par. 4 lidhur me par. 2 nenin 31 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.**

## II.

Po ashtu, me datë dhe kohë të njëjtë si në pikën I. të këtij aktgjykimi, i pandehuri **Dusan Drobac**, në koordinim me shumë të pandehurit të tjerë, ka marrë pjesë aktiv në grupin përkatësisht turmën e personave me qëllim të kryerjes së veprave penale serioze, të cilët përmes përdorimit të dhunës kanë tentuar që të pengojnë vendosjen e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës në komunat veriore të vendit, ashtu që edhe përkundër urdhrave të ushtarëve të misionit paqeruajtës të KFOR-it për shpërndarje të qetë të turmës dhe refuzim të hyrjes në objektin e komunës, i pandehuri, së bashku me të pandehurit tjerë kishin filluar që të **ushtrojnë dhunë të pakontrolluar, me mjete të forta, molotov, mjete shpërthyesë të improvizuara si dhe me armë zjarri, nga të cilat janë lënduar të paktën 30 (tridhjetë) pjesëtarë të forcave paqeruajtëse të KFOR-it, 3 (tre) nga ta nga predhat e armëve të zjarrit**, si dhe duke shkaktuar dëme materiale të konsiderueshme në automjetet e KFOR-it, të Policisë së Kosovës, si dhe në veturat e gazetarëve të cilët i kanë mbuluar ngjarjet e asaj dite, që përfshijnë djegien e plotë të disa automjeteve ose dëmtimin fizik në masë të madhe, çka me këto veprime kanë shkaktuar rrezik në shkallë të gjerë për jetën dhe trupin e shumë njerëzve dhe pasurisë.

- **Me këto veprime i pandehuri në bashkëkryerje e ka kryer veprën penale: *Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi*, nga neni 404 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve **4, 6, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 42, 44, 69, 70, 79 par.1, neni 402 par. 4 lidhur me par. 2 nenin 31, dhe neni 404 par. 1 lidhur me nenin 31, të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :**

## **G J Y K O N**

**I. Të pandehurit Dusan Drobac për veprën penale “*Sulmi ndaj personit zyrtar*”, e kryer në bashkëkryerje nga neni 402 par. 4 lidhur me par. 2 dhe nenin 31 të KPRK-së, i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej **18 muaj**, në të cilin dënim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgim nga data **24.07.2024**.**

**II. Të pandehurit Dusan Drobac, për veprën penale “*Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi*”, e kryer në bashkëkryerje nga neni 404 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej **6 gjashtë muajsh**,**

**Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit Dusan Drobac, dënimi me burg prej **6 muaj t’i** zëvendësohet në dënim me gjobë në **shumë prej 15,000.00 €**, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**

**Të pandehurit Dusan Drobac, në bazë të nenit 366, par.1, nen par 1.1 të KPPRK-së, i vazhdohet masa e paraburgimit derisa aktgjykimi të merr formë të prerë, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar në aktgjykim.**

**Të pandehurit, Dusan Drobac, i kthehet Telefoni i markës SAMSUNG Galaxy, A54 5G.**

Obligohet të pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej një qind (**100**) €, ndërsa shumën prej njëqind (**100**)

€, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A R S Y E T I M

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur aktakuzën PPS.nr. 44/23, datë 10.12.2024, kundër të pandehurit **Dusan Drobac** për shkak të veprave penale: *Sulmi ndaj personit zyrtar*, nga neni 402 par. 4 lidhur me par. 2 nenin 31 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, si dhe veprën penale: *Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi*, nga neni 404 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, e që aktakuzës ia ka bashkangjitur edhe Marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.44/23, e datës 09.12.2024.

Gjykata caktoi dhe mbajti seancën dëgjimore lidhur me marrëveshje për pranimin e fajësisë gjatë seancës me datë 18.12.2024, në të cilin seancë komfor nenit 241 par.3 të KPPK-të, Prokurori Special lexoi aktakuzën PPS.nr. 44/23, datë 10.12.2024, dhe në pika përmbledhëse elaboroi Marrëveshjen për pranimin e fajësisë të cilën e ka dorëzuar në gjykatë së bashku me aktakuzën, duke deklaruar qëndrojmë në tërësi pranë marrëveshjes të pranimit të fajësisë për të pandehurin e lartcekur, kjo marrëveshje është arritur pas kosnultimit të mjaftueshëm të avokates dhe të mbrojturit të saj e cila ka qenë prezent në çdo procedurë gjatë arritjes së kësaj marrëveshje, kjo marrëveshje me të pandehurin Dusan Drobac është arritur me pëlqimin dhe vullnetin e tij pa ndonjë presion dhe se i njëjti paraprakisht është njoftuar më pasojat dhe benefitetet e pranimit të kësaj fajësie, kërkoj nga gjykata ti shqiptohen dënimet e rekomanduar dhe të pajtuar në mes të dy palëve në këtë çështje penale sipas rekomandimeve të kësaj marrëveshje të cilën e kemi në formë të shkruar, andaj gjykatës i propozoj meqë kjo marrëveshje është arritur në mes të dy palëve të njëjtën ta aprovoj në tërësi.

Mbrojtësja e të pandehurit Dusan Drobac, Av. Drita Hoxha deklaroi se mbetem në tërësi pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë sepse është arritur pas konsultimeve të mjaftueshme me vullnet të plotë dhe pajtim të plotë dhe i mbrojturi im është pajtuar në tërësi me benefitet dhe pasojat që dalin nga kjo marrëveshje, konsiderojmë se më këtë marrëveshje janë marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, dhe me dënimet e arritura me këtë marrëveshje konsiderojmë që arrihet qëllimi i shqiptimit të dënimit, i propozojmë gjykatës që marrëveshjen për pranimin e

fajësisë ta aprovojë ashtu që për veprat penale të përshkuara në aktakuzë ti shqiptohet dënimet siç janë përshkruar në marrëveshje.

I pandehuri Dusan Drobac deklaroi se e kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë e kemi arritur së bashku me prokurorinë me vullnet të lirë dhe pa kurrfarë detyrimi, mirëpo ekziston vetëm një gjë të cilën dëshiroj ta theksoj dhe kjo është që mua si baba i tre fëmijëve më vjen keq për ushtaret e lënduar dhe se pendohem se kam qenë pjesë e asaj turme në të cilën kam marrë pjesë në atë ditë, edhe një gjë tjetër shumë me rëndësi për të cilën gjë ekzistojnë edhe incizimet tek prokuroria, veprimet e mija atë ditë e vërtetoj me garanci të plotë nuk kanë shkaktuar kurrfarë lëndime te ushtaret e KFOR-it edhe për këtë ekzistojnë incizimet mirëpo prap se prap do ta përmendi edhe një herë se pendohem plotësisht se kam qenë pjesë e asaj turme dhe ju premtoj se në të ardhmë më nuk do të ndodhë një gjë e tillë, fakti që jam prind i fëmijëve të mitur, fëmija me i ri i ka dy vite, më mungojnë shumë dhe kjo është arsyeja e vetme për të cilën do ta lusja gjykatën që ta marrin parasysht në shqyrtim për pranimin e fajësisë dhe të gjitha të tjerat, pasi që e pranoj marrëveshjen e lidhur mbi pranimin e fajësisë PPS.nr.88/2021 e datës 13.03.2024 dhe qëndroj në tërësi pranë kësaj marrëveshje.

Gjykata gjatë shqyrtimit të pranimi apo mospranimi të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, pas dëgjimit të prokurorit special, të pandehurit Dusan Drobac dhe mbrojtëses së tij, e komfor neni 230 par 17 të KPPK-së, përcaktoi se i pandehurit Dusan Drobac, në tërësi ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij dhe se nuk ka qenë i detyruar ose shtrënguar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat e paraqitura në nenin 248 par. 1 dhe 2 të këtij Kodi.

Gjykata pas marrjes së mendimit të prokurorit special, mbrojtëses dhe të pandehurit dhe pasi që është bindur se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara nga neni 230 par 17 të KPPK-së, komfor neni 230 par 20 të KPPK-së, me Aktvendim pranoi Marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.44/23, e datës 09.12.2024, të lidhur ndërmjet Kryeprokurorit të PSRK dhe Prokurorit Special në njërin anë si dhe të pandehurit dhe mbrojtëses në anën tjetër dhe urdhëroi që Marrëveshja të vendoset në shkresat e lëndës së kësaj gjykate, e që palët në procedurë janë pajtuar me pranimin e marrëveshjes se pranuar nga gjykata pa asnjë vërejtje.

Nga Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe deklaratat e prokurorit special, të pandehurit dhe mbrojtëses së tij, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprave penale: *Sulmi ndaj personit zyrtar*, nga neni 402 par. 4 lidhur me par. 2 nenin 31 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, si dhe veprën penale: *Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi*, nga neni 404 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, e të rekomanduar në Marrëveshjen e pranuar nga gjykata, e njëjta mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori sjelljen e tij korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit, pranimin e fajësisë, pendimin e thellë për veprat e kryera penale, sinqeritetin e tij deklarues, e të gjitha këto të përfshira në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, në të cilën janë dakorduar për vendimin mbi dënimin dhe lartësinë e tij, e duke pasur parasysh se gjykata e pranoi Marrëveshjen për pranimin e fajësisë, andaj edhe të pandehurit i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, e në pajtim me nenin 38 të KPRK-së, duke qenë e bindur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryerësve, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale (paushallin gjyqësor), është marrë komfor neneve 449, 450 dhe 452 të KPPRK, pasi që gjykata në këtë çështje penale ka marrë aktgjykim dënues.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave të krimit, gjykata e mori komfor nenit 36 par.3 nënpar.3.3 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit (Ligji Nr.08/L-109).

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiva të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI SPECIAL**  
**PS.nr.100/2024, Datë 18.12. 2024**

**Zyrtar ligjor,**  
Ardita Mustafa

**Kryetarja e trupit gjykues – Gjyqtarja**  
Violeta Namani-Hajra

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Prokurori Special, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë hequr dorë nga e drejta për ankesë.